

Njësia përgjegjëse që regjistron, heton administrativisht dhe shqyrton sinjalizime

Njësia përgjegjëse brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës, vendos me akt të ndërmjetëm të arsyetuar për riparimin e pasojave të paligjshme nga akti i hakmarrjes. Në rast të shkeljes së këtij afati, kërkesa e sinjalizuesit paraqitet tek ILDKPKI-ja, që vendos brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës për riparimin e pasojave të paligjshme të aktit të hakmarrjes.

Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së një kërkesë për mbrojtje nga hakmarrja, njofton me shkrim sinjalizuesin për regjistrimin e pretendimit dhe emrin e personit pranë Njesisë Përgjegjëse të Sinjalizimit, i cili do të ndjekë çështjen. Përmbajtja e regjistrimit të posaçëm për këtë qëllim përcaktohet me urdhër të veçantë të Inspektorit të Përgjithshëm.

Njësia Përgjegjëse të Sinjalizimit heton administrativisht sinjalizimin, në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 60/2016. Për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj, Njësia Përgjegjëse të Sinjalizimit zbaton dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.

Njësia Përgjegjëse të Sinjalizimit ka të drejtë të kërkojë informacione dhe dokumente, të urdhërojë inspektime ose analiza, të mbledhë deklaratat ose të pyesë persona në dijeni ose rrethanat e çështjes ose të konsultohet me ekspertë të fushave të ndryshme.

Në hetimin administrativ merr pjesë sinjalizuesi dhe çdo person tjetër i tretë, kur dyshohet se posedon dokumente ose ka dijeni për rrethanat e sinjalizuara, përfshirë dhe të sinjalizuarin, nëse vlerësohet e nevojshme nga Njësia Përgjegjëse të Sinjalizimit

Çdo palë pjesëmarrëse në hetimin administrativ i garantohet një proces i rregullt, në përputhje me parashikimet në Kodin e Procedurave Administrative, si dhe:
mund të japë deklaratat me shkrim, argumente ose opinione;
mund të konsultohet me dosjen e hetimit;
ka të drejtë të dëgjohet në lidhje me pretendimet e tij.

Njësia Përgjegjëse të Sinjalizimit njofton sinjalizuesin për çdo masë të marrë në përgjigje të sinjalizimit jo më vonë se 30 ditë nga momenti i kryerjes së veprimit. Pavarësisht nga afati i njoftimit të parashikuar në këtë pikë, Njësia Përgjegjëse të Sinjalizimit është e detyruar t'i përgjigjet brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për informacion, të paraqitur me shkrim nga sinjalizuesi, në çdo kohë, në lidhje me çështjen e sinjalizuar prej tij.

Njësia Përgjegjëse të Sinjalizimit merr masa të menjëhershme, të çastit dhe për aq sa është e mundur, për të parandaluar ose penguar vazhdimin e pasojave të dëmshme nga veprimi ose praktika e dyshuar e korrupsionit të sinjalizuar.

Nëse në përfundim të hetimit administrativ nga Njësia Përgjegjëse të Sinjalizimit rezulton se veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizuar përbën ose mund të përbëjë një shkelje administrative, sipas ligjit, Përgjegjësi Njesisë Përgjegjëse të Sinjalizimit sipas rastit, vë në dijeni organin kompetent.

Njësia Përgjegjëse të Sinjalizimi përfundon hetimin administrativ nëse: gjatë hetimit rezulton se sinjalizimi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit është i bazuar. Në këtë rast, Njësia Përgjegjëse të Sinjalizimi njofton menjëherë prokurorinë ose Policinë e Shtetit. sinjalizuesi nuk ka vepruar në kushtet e mirëbesimit, në zbatim të nenit 6 të ligjit nr.60/2016. Në dosjen e sinjalizimit shënohen vendimi për përfundimin e hetimit administrativ nga Përgjegjësi Njësise Përgjegjëse të Sinjalizimi , i arsyetuar për të gjitha shkaqet që kanë çuar në vendimmarrjen përkatëse, si dhe masat e marra në lidhje me sinjalizimin. Procedura e hetimit administrativ të sinjalizimit përfundon sa më shpejt të jetë e mundur, por, në çdo rast, jo më vonë se 60 ditë nga data e fillimit të hetimit, përveçse kur nga rrethanat kërkohet një afat më i gjatë.